

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

Lënda, P.no.215/11
Datë, 09 Nëntor 2011

Në Emër të Popullit

Gjykata e Qarkut në Pejë, trupi gjykues i përbërë nga Gjyqtari Malcolm Simmons si Kryetar i Trupit Gjykues dhe Gjyqtarët Dariusz Sielicki dhe Lumturie Muhaxheri si Anëtar të Trupit Gjykues, me procesmbajtësin Robert Abercrombie në lëndë penale kundër Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj, të akuzuar me Aktakuzën PPS. numër 102/10 të datës 31 Mars 2011, secili i akuzuar sipas Nenit 328 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës me një akuzë atë të Mbajtje në posedim, në kontroll ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, pas mbajtjes së gjykimit publik me datë 09 Nëntor 2011 ku nga Prokuroria u paraqit Ztr. Reshat Millaku ndërsa Ztr. Isa Osdautaj u paraqit për Muhamet Bojkaj, Ztr. Ylli Mekaj u paraqit për Ali Bojkaj dhe Ztr. Gafurr Elshani u paraqit për Gazmend Sylaj, në të cilin gjykim të pranishëm ish-in të pandehurit, me datë 09 Nëntor 2011 morri dhe publikisht shpalli këtë

AKTGJYKIM

1. I Akuzuari **Muhamet BOJKAJ**, emri i babës Ali, i lindur me 17 Qershor 1976 në fshatin Isniq, Komuna e Deçanit, me numër të Letërnjoftimit 1007009018, Shqiptar i Kosovës, shtetas i Republikës së Kosovës është

FAJTOR

Sepse:

Me datë 6 Nëntor 2010 gjatë bastisjes së shtëpisë së të pandehurit në fshatin Isniq, Komuna e Deçanit, Policia e Kosovës i gjeti në pronësi, në dhomën e tij të fjetjes, pushkën automatike AK47, me numër serik 3443 pa Kartë valide Autorizimi të Armës dhe gjashtë karikator dhe 180 fishekë të kal.7.62 x 39 mm.

Kështu, kreu veprën penale të Mbajtjes në Posedim, Kontroll ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armës sipas Nenit 328 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës

2. I Akuzuari **Ali BOJKAJ**, emri i babës Ali, i lindur më 1 Nëntor 1978 në fshatin Isniq, Komuna e Deçanit, me numër të Letërnjoftimit 1030301257, Shqiptar i Kosovës, shtetas i Republikës së Kosovës, është

FAJTOR

Sepse:

Me datë 6 Nëntor 2010 gjatë bastisjes së shtëpisë, në fshatin Isniq, Komuna e Deçanit, Policia e Kosovës i gjeti në pronësi, në dhomën e tij të fjetjes, një revolver, me numër serik 10010 pa Kartë valide Autorizimi të Armës dhe 5 fishekë,

Kështu, kreu veprën penale të Mbajtjes në Posedim, Kontroll ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armës sipas Nenit 328 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës

3. I Akuzuari **Gazmend SYLAJ**, emri i babës Gani, i lindur më 25 Shkurt 1982 në fshatin Grabanicë, Komuna e Klinës, me numër Letërnjoftimi 03238850, me vendbanim në lagjen "Tirolli", Pejë, kati i 2-të dhe 3-të, Shqiptar i Kosovës, shtetas i Republikës së Kosovës, është

FAJTOR

Sepse:

Gjatë periudhës kohore Maj 2010 deri më 10 Tetor 2010 në Pejë, i pandehuri kishte në pronësi dhe posedonte pa Kartë valide të Autorizimit të Armës, një revolver "Zastava", me kal.635 mm, me numër serik T647356 dhe katër fishekë.

Kështu, kreu veprën penale të Mbajtjes në Posedim, Kontroll ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armës sipas Nenit 328 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës

Prandaj, sipas dispozitave të Neneve, 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34 pikave 1 dhe 2, 38, 64 par 1, 65 par 1, 66 par. 1 nën-par. 2, 73 par 1, 99 par 1, Nenit 328 par. 2 të KPK-së dhe Neneve 99 par 1, 2 pikave 3, 4, 6, par 3, 102 par. 1, 328 par 1, 385 par. 1 dhe 2, 386 par 2, 387 par 1 dhe 2, 391 dhe 392 të KPPK-së, të akuzuarit

DËNOHEN

Muhamet Bojkaj me 8 (tetë) muaj burg

Ali Bojkaj me 3 (tre) muaj burg

Gazmend Sylaj me 3 (tre) muaj burg

Sipas nenit 391 par. 1 nën-par. 5 të KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim nga i akuzuari Gazmend Sylaj nga data 10 Tetor 2010 deri më datë 30 Dhjetor 2010 do të llogaritet në dënim.

Sipas nenit 328 par. 5 të KPK-së, pushka automatike AK47, me numër serik 3443 dhe gjashtë karikator dhe 180 fishekë, të kal.7.62 x 39 mm të marra nga Muhamet Bojkaj do të konfiskohen dhe do të shkatërrohen.

Sipas nenit 328 par. 5 të KPK-së, revolveri, me numër serik 10010 dhe 5 fishekët të marra nga Ali Bojkaj do të konfiskohen dhe do të shkatërrohen.

Sipas nenit 328 par. 5 të KPK-së, revolveri "Zastava", i kal.635 mm, me numër serik T647356 dhe katër fishekët e marr nga Gazmend Sylaj do të konfiskohen dhe do të shkatërrohen.

Secili i pandehur do të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) Eurove.

ARSYETIM

1. Prapavija Procedurale

i. Aktakuza

Me datë 07 Prill 2011 Zyra e Prokurorisë Speciale ngriti aktakuzën PPS.nr.102/10 kundër të pandehurve Bedri Krasniqi Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj, Hime Krasniqi, Selman Gashi, Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj për veprë penale *Krim i Organizuar* në kundërshtim me Nenin 274 par. 1 lidhur me veprën penale të *Kidnimit* sipas Nenit 159 par. 2 të KPK-së, dhe *Mbajtjes në posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim me Nenin 328 par. 2 dhe 3 të KPK-së. Më sipër është vënë në pah se cila veprë penale lidhet me cilin të pandehur veç e veç.

Me datë 20 Maj 2011 gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Pejë konfirmoi aktakuzën e cekur më lart me Aktvendimin KA.nr.143/11.

Me të njëjtin aktvendim gjyqtari për konfirmim vendosi që procesi gjyqësor kundër Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj duhej të ndahej, pasi që këta të pandehur ishin akuzuar vetëm për *mbajtje në posedim, kontroll dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim me Nenin 328 par. 2 të KPK-së.

Gjatë seancës dëgjimore për konfirmim të aktakuzës të pandehurit Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj pranuan fajësinë.

ii. Kompetenca e Gjykatës dhe Përbërja e Trupit Gjyqësor

Sipas Nenit 23 (1) të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut kanë kompetencë të gjykojnë me shkallë të parë veprat penale të

dënueshme me së paku pesë vite burgim apo veprat penale të dënueshme me burgim afat gjatë.

Në rastin aktual të pandehurit akuzoheshin për mbajtje në posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 par. 2 të KPK-së, vepër e dënueshme me gjobë ose burgim nga një deri në tetë vite.

Veprat penale, sipas Aktakuzës, janë kryer në Pejë dhe fshatin Isniq, Komuna e Deçanit, e që i përket territorit të Regjionit të Pejës. Prandaj, në përputhshmëri me Nenin 27 (1) të KPPK-së, Gjykata e Qarkut të Pejës ka juridiksion territorial për të gjykuar këtë lëndë.

Palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim sa i përket juridiksionit të kësaj gjykate.

Përveç kësaj, në përputhshmëri me Nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksionin Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë (tani e tutje "LmJ"), Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar për proces gjyqësor kanë juridiksion dhe kompetenca mbi të gjitha lëndët të hetuara apo të ndjekura penalisht nga Prokurorët Special të Republikës së Kosovës.

Pasi që lënda në fjalë është hetuar dhe Aktakuza është parashtruar nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës Trupi Gjykses i Gjykatës së Qarkut në Pejë është në përbërje të duhur nga një panel i përzier prej dy Gjyqtarëve të EULEX-it dhe një Gjyqtari vendor në pajtim me nenin 4.7 të LmJ.

Palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim sa i përket përbërjes së kësaj Gjykate.

iii. Shqyrtimi Kryesor

Shqyrtimi kryesor ishte i hapur për publikun dhe u mbajt me datë 09 Nëntor 2011 në prezencën e Prokurorit Publik Reshat Millaku, të akuzuarit Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj si dhe avokateve të tyre mbrojtës Isa Osdautaj, Ylli Mekaj dhe Gafurr Elshani.

Në përputhshmëri me Nenin 15 të KPPK-së, përkthyes ndërkombëtar përkthyen procesin gjyqësor të kësaj gjykate

si dhe të gjitha dokumentet relevante për këtë gjykim nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas, sipas nevojës.

2. Gjendja faktike

Me datë 10 Tetor 2010, gjatë hetimeve lidhur me kidnapimin e Azem Morinës, policia bastisi shtëpinë e Gazmend Sylaj. Gjatë bastisjes policia konfiskoi një armë, revolver "Zastava", të kalibrit 635 mm, me numër serik T647356 dhe katër plumba.

I pandehuri pranoi se e kishte atë armë pa leje, gjatë intervistës që iu bë në Zyrën e Prokurorit Special me datë 28 Tetor 2010. Gjykata gjen se gjatë gjithë kohës për të cilën e kemi fjalën arma dhe municioni ishin në pronësi, mbajtje dhe kontroll të të pandehurit.

Me datë 6 Nëntor 2010 policia bastisi shtëpinë e Muhamet Bojkaj dhe Ali Bojkaj në fshatin Isnig, Komuna e Deçanit. Dy të pandehurit janë vëllezër. Gjatë kësaj bastisjeje policia konfiskoi një pushkë automatike AK47, me numër serik 3443, gjashtë karikator dhe 180 plumba, të kal.7.62 x 39 mm, dhe një revolver me numër serik 10010 me 5 plumba.

I pandehuri Muhamet Bojkaj pranoi se ishte në pronës të pushkës automatike AK47 dhe 180 plumbave, qysh nga lufta, gjatë intervistës që iu bë atij në Zyrën e Prokurorisë Speciale me datë 07 Dhjetor 2010. Gjykata gjen se gjatë gjithë kohës për të cilën e kemi fjalën, arma dhe municioni ishin në pronësi, mbajtje dhe kontroll të të pandehurit.

I pandehuri Ali Bojkaj pranoi se ishte në pronësi të revolverit kur u intervistua nga policia me datë 08 Nëntor 2010. Ai deklaroi se revolverin dhe municionin ia kishte dhënë atij si dhuratë babai i tij i ndjerë. Gjykata gjen se gjatë gjithë kohës për të cilën e kemi fjalën arma dhe municioni në fjalë ishin në pronësi, mbajtje dhe kontroll të të pandehurit.

Të gjithë të pandehurit pranuan fajësinë për veprën penale të *mbajtjes në posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim me Nenin 328 par. 2 të KPK-së.

Duke pasur parasysh dëshmitë e Prokurorisë trupi gjykues vendosi të pranoj fajësinë e pranuar.

1. Fjala përfundimtare

Gjatë fjalës përfundimtare prokurori qëndroj prapa aktakuzës dhe duke pasur parasysh fajësinë e pranuar nga ana e të pandehurve, kërkoi që të pandehurit të dënohen në pajtim me ligjin.

Të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës kërkuan që ndaj tyre të vihet një dënim i butë, duke propozuar gjobë, pasi që ata kishin pranuar fajësinë dhe premtuan që asnjëherë nuk do të posedojnë armë.

2. Përcaktimi i Dënimit

Trupi gjykues, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konsideron se dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është i përshtatshëm.

I pandehuri **Muhamet Bojkaj** ishte në pronësi të paautorizuar të Pushkës Automatike AK47 dhe 180 fishekëve municion. Ai posedonte këtë armë që nga lufta. Megjithatë, përkundër së paku një amnistie dhe çdo mundësi për ta dorëzuar këtë armë të paautorizuar autoriteteve në mënyrë vullnetare, ai këtë gjë nuk e bëri.

Nuk kishte arsye, ligjore, legjitime perse i pandehuri kishte qenë posedim të armës dhe municionit në fjalë.

Posedimi i armës automatike si dhe një numri domethënës të municionit paraqiste një kërcënim serioz për sigurinë dhe mbrojtjen e publikut. Posedimi i armës automatike si dhe një numri domethënës të municionit meriton përbuzjen më të rëndë të Gjykatës.

Gjykata ka konsideruar dhe marr parasysh faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë në fazën më të hershme. I pandehuri është njeri familjar; ai ka tre fëmijë të cilët janë nën moshën 10 vjeçare. I pandehuri është i vetmi mbajtës i familjes.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e cekura më lartë, dënimi prej 8 (tetë muaj burgim është i përshtatshëm, duke

pasur në mendje se është nën minimumin e përshkruar me ligj.

I pandehuri **Ali Bojkaj** ishte në posedim të paautorizuar të një revolveri me numër serik 10010 për të cilën ai nuk kishte kartelet autorizimi valide të armës si dhe 5 plumbave. Nuk kishte arsye, ligjore, legjitime për të poseduar pistoletë dhe plumba. Fakti se armën ia kishte dhënë babai i tij i ndjerë nuk ishte arsye i arsyeshëm, i justifikueshëm apo ligjor që ai të mbante armën dhe municionin në fjalë.

Si rrethanë lehtësuese, Gjykata mori parasysh faktin se i pandehuri pranoi fajësinë në mundësin e parë.

Duke pasur parasysh faktet e sipër përmendura, dënimi prej 3 (tre) muajve burgim është i përshtatshëm dhe i arsyeshëm me rrethanat.

I pandehuri Gazmend Sylaj ishte në mbajtje të paligjshme të pistoletës dhe katër plumbave.

Si rrethanë lehtësuese, gjykata morri parasysh faktin se i pandehuri pranoi fajësinë në rastin më të hershem. Gjykata morri parasysh po ashtu se i pandehuri Gazmend Sylaj është i martuar rishtazi dhe ka një fëmijë të vogël.

Duke pasur parasysh faktet e sipër përmendura, dënimi prej 3 (tre) muajve burgim është i përshtatshëm dhe i arsyeshëm me rrethanat.

Dënimet e vëna ndaj secilit prej tre të pandehurve janë nën minimumin e përshkruar me ligj.

3. Shpenzimet

Sipas Nenit 102 paragrafi (1) lidhur me Nenin 99 paragrafi (1) dhe (2) nënparagrafët 6) të KPPK-së, secili nga të pandehurit, do të paguajnë Shumën e Caktuar në shumë prej 100 (njëqind) Eurosh.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË
Sot me datë 09 Nëntor 2011
P.nr.215/11

Kryetari i Trupit Gjykes



Malcolm Simmons

Anëtar i Trupit Gjykes

Anëtar i Trupit Gjykes

Dariusz Sielicki

Lumturiqe Muhaxheri

Procesmbajtës

Robert Abercrombie

KËSHILLË LIGJORE:

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës së Qarkut në Pejë drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e marrjes së këtij aktgjykimi.